

POLITIKA MBI CILËSINË

DAK-PO-01

MIRATUAR NGA,
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Gentiana ISLAMAJ

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	3
6. ANEKSET	4
7. REGJISTRAT	4
8. HISTORIA	4

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan Politikën e Cilësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK).

2. REFERENCAT

- Ligji Nr. 05/L-117 për akreditim
- ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat për vlerësimin e konformitetit.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë është e detyrueshme dhe vlen për të gjithë personelin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK të përfshirë në akreditim, siç janë stafi i DAK, KP, KA, KT dhe vlerësuesit dhe ekspertët.

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj Politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

DAK - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

EA – European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)

EA BLA – European Accreditation Bilateral Agreement (Marrëveshja bilaterale për njohjen e Akreditimit Evropian)

ILAC – International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve)

ILAC MRA – International Laboratory Accreditation Council (Marrëveshje e ndërsjellë për njohjen e ILAC).

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

DAK ofron shërbime të akreditimit në mënyrë profesionale, të paanshme, transparente dhe jo-diskriminuese dhe është plotësisht e vetëdijshme për rolin e saj. DAK është pjesë e infrastrukturës së cilësisë dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë së Kosovës.

DAK është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së vet në përputhje me Ligjin nr. 05/L-117 për akreditim, legjislacionin kombëtar në lidhje me akreditimin, ISO/IEC 17011:2017 dhe dokumentet e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA) dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Akreditimin e Laboratorëve (ILAC).

Sipas kërkesave të dokumenteve të lartpërmendura, DAK nuk ofron shërbime si konsulencë ose aktivitete të tjera me qëllim të marrjes dhe mbajtjes së akreditimit, të cilat mund të ndikojnë në besueshmërinë dhe paanshmërinë e saj.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë i DAK është krijuar, dokumentuar, zbatuar dhe mirëmbajtur. DAK vazhdimisht përmirëson efektivitetin e sistemit të saj të menaxhimit. DAK kontrollon zbatimin e politikës së cilësisë dhe politikave të tjera përmes rezultateve të auditimeve të brendshme, kënaqësisë së klientëve dhe autoriteteve së bashku me statusin e efektivitetit të veprimeve korrigjuese, masave që rrjedhin nga rishikimet e menaxhimit, ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë, si dhe si rekomandime për përmirësim.

DAK është e vetëdijshme që vetëm stafi i trajnuar dhe kompetent, me përvojë praktike janë çelësi i një ecurie të përshtatshme dhe efektive të proceseve të akreditimit. Prandaj, DAK organizon trajnime të vazhdueshme për stafin e saj (të brendshëm dhe të jashtëm), si dhe monitoron efektivitetin e tyre.

Objektivat e cilësisë janë si më poshtë:

- Rritja e kënaqësisë së autoriteteve dhe klientëve,
- Ulja e numrit të ankesave dhe parashtresave,
- Ulja e nevojës për veprime korrigjuese,
- Përfshirja e suksesshme e kryevlerësuesve dhe vlerësuesve teknikë në proceset e akreditimit,
- Zhvillimi i skemave të reja të akreditimit,
- Trajnimi i stafit të brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së të përfshirë në proceset e akreditimit,
- Vlerësimi i programeve të punës të realizuara dhe planeve financiare,
- Azhurnim i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të DAK-së sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, rregullave dhe dokumenteve të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit (EA dhe ILAC),
- Arritja e njohjes evropiane dhe ndërkombëtare (EA BLA, ILAC MRA).

Stafi i DAK-së është i vetëdijshëm që sistemi i menaxhimit duhet të zbatohet pa devijime dhe mangësi dhe ky sistem duhet të zbatohet gjithashtu nga secili person që është i përfshirë në aktivitetet e DAK-së.

6. ANEKSET

Nuk aplikohet

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
02.12.2015	Ibush Luzha	Dokument i ri.
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017